

Shtojca 7

(Shtojce per t'u plotësar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

DETYRË PROJEKTIMI

“Sherbime Projektimi – RIKONSTRUKSION I RRUGËVE AUTO. “KODËR BOJË - BUSHAT, KODËR BOJË - MARDHNAQ”, “QERRET”, “KORTHPULË”

Lloji i dokumentit	Terma Reference / Detyrë projektimi për sherbime projektimi
Kategoria	Struktura transporti dhe qarkullimi
Gjatësia orientuese e segmenteve	13.533 ml
Kosto orientuese e punimeve pa TVSH	431 975 837,00 lekë
Kosto orientuese e punimeve me TVSH	518 371 004,40 lekë
Data	/ / 2026

Përgatitur për përdorim në procedurën e prokurimit të shërbimit të projektimit.

2026

PËRMBAJTJA

1. Qëllimi i detyrës së projektimit
2. Të dhënat bazë të objektit
3. Objektivat teknike dhe funksionale
4. Baza ligjore dhe standardet referuese
5. Gjendja ekzistuese dhe verifikimet në terren
6. Kërkesat për rilevim topografik dhe studime ndihmëse
7. Kërkesat për projektimin gjeometrik të rrugës
8. Kërkesat për shtresat rrugore dhe trupin e rrugës
9. Kërkesat për kullimin, veprat e artit dhe mbrojtjet
10. Siguria rrugore, sinjalistika dhe elementët ndihmës
11. Fazat, produktet dhe dokumentacioni që dorëzohet
12. Preventivi, fondi orientues dhe kontrolli i kostos
13. Grafiku, përgjegjësitë dhe kriteret e pranimi
14. Përfundime

1. QËLLIMI I DETYRËS SË PROJEKTIMIT

Kjo detyrë projektimi përcakton kërkesat teknike, funksionale, ligjore dhe dokumentare për “Sherbime projektimi – Rikonstruksion i rrugëve auto. “Kodër Bojë - Bushat, Kodër Bojë - Mardhnaq”, “Qerret”, “Korthpulë”, të segmenteve rrugore auto që lidhin fshatrat dhe njësitë e zonës me rrjetin ekzistues rrugor. Dokumenti shërben si bazë për përzgjedhjen e projektuesit, për kontrollin e cilësisë së projektit.

Qëllimi kryesor është hartimi i një projekti të zbatueshëm, ekonomik dhe të sigurt për rehabilitimin/ndërtimin e segmenteve rrugore, duke përfshirë trupin e rrugës, shtresat, kullimin, veprat e artit, sinjalistikën, elementët e sigurisë rrugore dhe preventivin përfundimtar.

2. TË DHËNAT BAZË TË OBJEKTIT

Objekti i shërbimit është: Sherbime projektimi – “Rikonstruksion i rrugëve auto. “Kodër Bojë - Bushat, Kodër Bojë - Mardhnaq”, “Qerret”, “Korthpulë”. Në materialin teknik shfaqet edhe emërtimi i përgjithshëm për fshatrat Bushat, Qerret, Korthpulë; projektuesi duhet të verifikojë përputhjen e emërimit zyrtar të objektit me njësinë investitore para dorëzimit të projektit final.

Nr.	Segmenti	Gjatësia orientuese	Vlera pa TVSH (lekë) orientuese	Vlera me TVSH (lekë) orientuese
1,2	Kodër Bojë - Bushat dhe Kodër Bojë - Mardhnaq	4.715 ml	162 318 658,34	194 782 390,01
3	Rruga auto Qerret	4.214 ml	30230776,64	181 384 659,86
4	Korthpulë	4.604 ml	23700659,09	142.865.191

Gjatësia totale orientuese e segmenteve është 13.533 ml. Vlera orientuese e punimeve është 431.975.837.00 lekë pa TVSH dhe 518.371.004.40 lekë me TVSH. Këto vlera janë orientuese dhe shërbejnë si kosto e llogaritshme për përcaktimin e fondit limit të kontratës së projektimit.



Fig.1 Segmenti rrugor: Kodër Bojë - Bushat



Fig.2 Segmenti rrugor: Kodër Bojë - Dushnez



Fig.3 Rruge te brendshme Qerret



Fig.4 Rruge te brendshme Qerret



Fig.5 Rruge te brendshme Qerret



Fig.6 Rruge auto. Qerret



Fig.7 Rruge auto. Korthpule



Fig.8 Rruge auto. Korthpule



Fig.9 Rruge auto. Korthpule

3. OBJEKTIVAT TEKNIKE DHE FUNKSIONALE

- Të sigurohet akses i qëndrueshëm, i sigurt dhe funksional për banorët, shërbimet publike, mjetet e emergjencës dhe aktivitetet ekonomike lokale.
- Të përmirësohet kalueshmëria në terren të thyer, duke reduktuar pikat kritike të rrëshqitjes, erozionit, mungesës së kullimit dhe dëmtimeve të shtresave.
- Të projektohen elementë rrugorë të përshtatur me relievin, kufizimet e pronësisë, rrjetet ekzistuese dhe mundësitë reale të zbatimit.
- Të sigurohet një zgjidhje teknike me kosto të arsyeshme gjatë ndërtimit dhe mirëmbajtjes, duke shmangur zgjidhje të panevojshme të shtrenjta.
- Të hartohet dokumentacion i plotë: projekt ide, projekt zbatimi, vizatime, llogaritje, specifikime, preventiv dhe grafiku i punimeve.

4. BAZA LIGJORE DHE STANDARDET REFERUESE

Projektimi duhet të mbështetet në legjislacionin shqiptar në fuqi për planifikimin, projektimin, ndërtimin, prokurimin publik, sigurinë në punë, mbrojtjen e mjedisit dhe administrimin e rrjetit rrugor. Për llogaritjen e tarifës së shërbimit është përdorur VKM nr. 354, datë 11.05.2016.

- VKM nr. 354, datë 11.05.2016, për manualin e tarifave të shërbimeve në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim.
- Kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit të rrugëve, veprave të artit, tombinove, mureve mbajtëse dhe shtresave rrugore.
- Standardet për sinjalistikën vertikale dhe horizontale, pajisjet mbrojtëse anësore, guardrail dhe elementët e qetësimit të trafikut.
- Rregulloret për sigurinë në kantier, menaxhimin e trafikut gjatë punimeve dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Normat e projektimit hidraulik për largimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

5. GJENDJA EKZISTUESE DHE VERIFIKIMET NË TERREN

Projektuesi duhet të kryejë inspektim të detajuar në të gjithë gjatësinë e segmenteve. Verifikimi në terren nuk duhet të kufizohet vetëm në aksin ekzistues, por duhet të përfshijë skarpatat, përrenjtë, pikat e rrëshqitjeve, zonat e erozionit, hyrjet në prona, lidhjet me rrugët dytësore dhe zonat ku kërkohet devijim ose zgjerim.

- Identifikimi i gjendjes së trupit të rrugës, gjerësive ekzistuese, dëmtimeve, deformimeve dhe mungesës së shtresave.
- Inventarizimi i tombinove, kanaleve anësore, shkarkimeve, urave të vogla, mureve mbajtëse dhe kalimeve ekzistuese.
- Verifikimi i linjave të ujësjellësit, kanalizimeve, energjisë, telekomunikacionit dhe çdo infrastrukture që mund të preket nga punimet.
- Përcaktimi i pikave ku nevojiten masa mbrojtëse, gabione, mure, drenazhe, guardrail dhe sinjalistikë paralajmëruese.
- Fotografi dhe hartimi i një albumi teknik me pozicionim kilometrik për çdo problematikë.

6. KËRKESAT PËR RILEVIM TOPOGRAFIK DHE STUDIME NDIHMËSE

Rilevimi topografik duhet të realizohet në sistem koordinativ zyrtar dhe të dorëzohet në format DĚG, PDF dhe në tabela koordinatash. Aksi i rrugës duhet të piketohet me stacione të rregullta, me dendësi më të madhe në kthesa, në zona problematike dhe në pikëtakimet me veprat e artit.

- Rilevim planimetrik dhe altimetrik i aksit, bankinave, skarpatave, objekteve ekzistuese, kanaleve dhe pikave të shkarkimit.
- Profil gjatësor i çdo segmenti dhe profile tërthore në intervale të përshtatshme, jo më të rralla se 25 m në terren të thyer dhe më të dendura në kthesa/pika kritike.
- Studim gjeologo-inxhinierik për zonat me rrëshqitje, mbushje të larta, gjurmime të thella, mure mbajtëse dhe vepra arti.
- Vlerësim hidrologjik/hidraulik për përrenjtë dhe rrjedhjet që ndërpresin rrugën, për dimensionimin e tombinove dhe kanaleve.
- Identifikim i burimeve të materialeve, distancave të transportit dhe mundësive të depozitimit të dherave.

7. KËRKESAT PËR PROJEKTIMIN GJEOMETRIK TË RRUGËS

Projektimi gjeometrik duhet të përshtatet me kategorinë funksionale të rrugës dhe aksit ekzistues të rrugëve auto, terrenin e thyer dhe kufizimet lokale. Zgjidhja duhet të synojë përmirësim të sigurisë dhe kalueshmërisë pa prodhuar gjurmime, mbushje apo shpronësime të panevojshme.

- Përcaktimi i aksit optimal në plan dhe profil, duke shmangur sa më shumë zonat me rrezik gjeoteknik dhe prurje ujore.
- Përcaktimi i gjerësisë së karrexhatës, bankinave, zgjerimeve në kthesa dhe hapësirave të ndalimit sipas kushteve reale të terrenit.
- Kthesat horizontale dhe vertikale të projektohen me rreze të përshtatshme për shpejtësi të ulët/mesatare dhe qarkullim rural.
- Në segmentet me pjerrësi të lartë të parashikohen masa kundër rrëshqitjes dhe largim i kontrolluar i ujërave.
- Në hyrje të banesave, tokave bujqësore dhe objekteve publike të parashikohen lidhje funksionale me rrugën kryesore.
- Referuar trafikut të qarkullimit, rekomandohet shtresa asfaltike me gjerësi rreth 3.5m.

8. KËRKESAT PËR SHITESAT RRUGORE DHE TRUPIN E RRUGËS

Nga inspektimet dhe nevojat që paraqesin rrugët në terren rekomandohet: shtresa çakelli, stabilizanti, binder dhe asfaltobeton. Projektuesi duhet të verifikojë përbërjen finale të paketës së shtresave përmes analizës së trafikut, gjendjes së nën-shtresës, kapacitetit mbajtës të terrenit dhe kushteve klimatike.

- Pastrimi, gjurmimi, formimi i trupit të rrugës dhe ngjeshja e shtresës bazë sipas kërkesave teknike.
- Shtresa çakelli/zhavorri dhe stabilizanti të dimensionohen sipas rezultateve të terrenit dhe nivelit të trafikut.

- Shtresat bituminoze të përfshijnë binder dhe asfaltobeton sipas trashësive të miratuara në projektin e zbatimit.
- Të parashikohen prova laboratorike për materialet granulare, betonin, asfaltin, ngjeshjen dhe cilësinë e zbatimit.
- Të trajtohen veçmas zonat me lagështi, terren të dobët ose nënkalime ujore me drenazhime dhe shtresa përforcuese.

9. KËRKESAT PËR KULLIMIN, VEPRAT E ARTIT DHE MBROJTJET

Duke qenë se objekti klasifikohet në terren të thyer dhe me kushte të vështira të kullimit, sistemi i largimit të ujërave është pjesë thelbësore e projektit. Çdo zgjidhje për shtresat rrugore duhet të shoqërohet me zgjidhje për kanalet, tombinot, drenazhet dhe mbrojtjen e skarpatave.

- Të dimensionohen kanalet anësore, kunetat, shkarkimet tërthore dhe pikat e derdhjes pa shkaktuar erozion në pronat përreth.
- Tombinot ekzistuese të verifikohen për kapacitet, gjendje fizike dhe nevojë zëvendësimi; të parashikohen tuba betoni Ø800, Ø1000 ose dimensione të tjera sipas llogaritjes.
- Të projektohen mure mbajtëse, mbushje me shkëmb, mbrojtje me gabione ose zgjidhje të tjera në zonat ku rrezikohet stabiliteti.
- Të parashikohen puseta kontrolli, puseta shkarkimi dhe elementë të ujësjellës-kanalizimeve të jashtme kur preken nga rruga.
- Të gjitha veprat e artit të shoqërohen me vizatime, detaje armimi, specifikime betoni dhe llogaritje teknike.

10. SIGURIA RRUGORE, SINJALISTIKA DHE ELEMENTËT NDIHMËS

Në projekt duhet të trajtohet siguria e përdoruesve të rrugës, sidomos në kthesa, pjerrësi, zona me skarpata, hyrje në fshatra, afër banesave dhe në pikat ku rruga ndërpritet nga rrjedhje ujore. Sinjalistika duhet të jetë e lexueshme, e qëndrueshme dhe në përputhje me standardet.

- Guardrail anësor N2 në zonat me rrezik daljeje nga rruga, mbushje të larta, kanale të thella ose kthesa të mprehta.
- Tabela paralajmëruese, treguese dhe informuese, përfshirë tabela lokaliteti dhe tabela të mëdha informuese ku kërkohet.
- Vijëzim horizontal gjatësor dhe anësor me material bikomponent/sprajt sipas projektit të sinjalistikës.
- Përvijues anësorë dhe elementë reflektues në segmentet me shikueshmëri të kufizuar.
- Ngadalësues shpejtësie dhe sinjalistikë shoqëruese në hyrje të qendrave të banuara, pranë shkollave, kryqëzimeve ose pikave me trafik këmbësorësh.

11. FAZAT, PRODUKTET DHE DOKUMENTACIONI QË DORËZOHET

Shërbimi i projektimit duhet të organizohet në faza të qarta. Relacioni teknik i fondit limit parashikon për shërbimin fazat: Faza III - Projekt ideja përfundimtare, Faza V - Projekti i zbatimit dhe Faza VI - Preventivi përfundimtar, me peshë totale 50% të tarifës së plotë të projektim + mbikëqyrje.

Faza	Emërtimi	Produktet kryesore
Faza III	Projekt ideja përfundimtare	Raport teknik, variante, planimetri, profil gjatësor orientues, vlerësim kostoje dhe rekomandim i variantit.
Faza V	Projekti i zbatimit	Vizatime zbatimi, profile, detaje, llogaritje, specifikime teknike, plan sigurie, plan menaxhimi trafiku dhe mjedisi.
Faza VI	Preventivi përfundimtar	Preventiv me zëra pune, analizë çmimesh kur nevojitet, volumetri, grafiku i punimeve dhe fondi përfundimtar.

12. PREVENTIVI, FONDI ORIENTUES DHE KONTROLLI I KOSTOS

Preventivi orientues përfshin 11 kapituj pune: gjërmime, vepra arti dhe kanalizime, betone e betonarme, punime të ndryshme, ujësjellës-kanalizim i jashtëm, hekur betoni, shtresa, analiza teknike/asfaltike, sinjalistikë vertikale, sinjale horizontale dhe pajisje shtesë/normalizues shpejtësie. Projektuesi duhet të verifikojë çdo zë pune dhe të përditësojë sasinë sipas projektit final.

Nr.	Kapitulli	Vlera orientuese pa TVSH (lekë)
1	Punime gjërmimi	19 645 317,46
2	Vepra arti + kanalizime	22 541 389,10
3	Punime betoni e betonarmeje	146 255 229,35
4	Punime të ndryshme	7 766 882,83
5	Ujësjellës e kanalizim i jashtëm	5 369 611,25
6	Punime hekur betoni	1 170 419,90
7	Punime shtresash	60 125 540,71
8	Analiza teknike / shtresa asfaltike	140 503 441,26
9	Të ndryshme, elektrike dhe sinjalistika	19 843 589,60
10	Sinjalet horizontale	6 259 553,82
11	Sinjalet dhe pajisjet shtesë	2 494 861,70

Preventivi është orientues dhe shërben për orientimin e grup-kapitujve të zerave të punimeve që duhet të udhëheqin realizimin e hartimit të projektit, si dhe qëllimi kryesor për përcaktimin e kostos së llogaritur në llogaritjen e shërbimit të projektimit.

13. GRAFIKU, PËRGJEGJËSITË DHE KRITERET E PRANIMIT

Afati i rekomanduar për hartimin e dokumentacionit të projektimit është 60 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës ose nga data e urdhrit të fillimit.

- Dita 1-5: grumbullimi i dokumentacionit, vizita në terren, rilevimi paraprak dhe programi i studimeve.
- Dita 6-19: rilevimi topografik, inventarizimi i problematikave, studimi hidrologjik dhe gjeoteknik sipas nevojës.
- Dita 20-29: hartimi i projekt-idesë përfundimtare dhe miratimi i variantit teknik.
- Dita 30-55: hartimi i projektit të zbatimit, vizatimeve, llogaritjeve, detajeve dhe specifikimeve.
- Dita 56-60: preventivi përfundimtar, kontrolli i brendshëm i cilësisë, dorëzimi fizik dhe elektronik.

Pranimi i projektit do të bëhet vetëm nëse dokumentacioni është i plotë, i nënshkruar, i vulosur, i koordinuar ndërmjet pjesëve teknike dhe i dorëzuar në format Word/PDF për relacionet, Excel/PDF për preventivat dhe DWG/PDF për vizatimet.

14. PËRFUNDIME

Detyra e projektimit përcakton kërkesat minimale që projektuesi duhet të plotësojë për të prodhuar një projekt të zbatueshëm për segmentet rrugore të përmendura. Theksi kryesor duhet të vendoset në saktësinë e matjeve, menaxhimin e ujërave, stabilitetin e trupit të rrugës, cilësinë e shtresave, sigurinë rrugore dhe kontrollin e kostos. Çdo ndryshim nga të dhënat orientuese duhet të argumentohet teknikisht dhe të miratohet nga investitori përpara finalizimit të projektit.

15. FIRMAT

Përgatiti	_____
Kontrollloi	_____
Miratoi	Bashkia Pukë Kryetari Z. Rrok DODA
Data	____ / ____ / 2026